

**VENDIM**  
**Nr.404, datë 9.6.2005**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË  
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA NDËRTIMI I NËNSTACIONIT  
110/20 KV, PORTO-ROMANO, DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i nënstacionit 110/20 kV, Porto-Romano, Durrës, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të KESH, sh.a.-së, Tiranë.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet, të kompensohet në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 4875 (katër mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë) m<sup>2</sup> tokë bujqësore arë, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 8 287 500 (tetë milionë e dyqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind) lekësh.

4. Ky fond të përballohet nga fondet e investimeve të KESH sh.a.-së, Tiranë zëri “Kosto lokale për shpronësimet”.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të shpronësimit, në shumën 130 000 (njëqind e tridhjetë mijë) lekë, të jetë në ngarkim të KESH sh.a.-së, kërkuese për shpronësim.

6. Shpronësimi të fillojë brenda muajit qershor 2005 dhe të përfundojë brenda muajit korrik 2005.

7. Punimet për ndërtimin e këtij nënstacioni kanë filluar në mars 2005 dhe do të përfundojnë në maj 2006.

8. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës dhe KESH sh.a. Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

**LISTA E PRONARËVE QË SHRONËSOHEN PËR EFEKT TË “NDËRTIMIT TË  
NËNSTACIONIT 110/20 KV NË ZONËN E PORTO-ROMANOS, DURRËS”**

Rrethi: Durrës  
Komuna: Spitallë

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: Tokë bujqësore arë.

| Nr. | Emri   | Atësia | Mbiemri | Lloji i pasurisë | Zona kadastrale | Nr. pasurisë | Sipërfaqja e përgjithshme m <sup>2</sup> | Çmimi lekë/m <sup>2</sup> | Vlera e kompensimit në lekë |
|-----|--------|--------|---------|------------------|-----------------|--------------|------------------------------------------|---------------------------|-----------------------------|
| 1   | Feti   | Jusuf  | Istrefi | Tokë bujqësore   | 8517            | 98/6         | 4875                                     | 1700                      | 8 287 500                   |
|     | Totali |        |         |                  |                 |              |                                          |                           | 8 287 500                   |

Sqarime: Shpenzime procedurale: 1. Publikime 105 000 (njëqind e pesë mijë) lekë.

2.Shpërblim i anëtarëve të komisionit 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë.

Vlefë totale e shpronësimit = 8 287 500 + 130 000 + 8 417 500 lekë.

